

1. An. Metilda Gjuri
2. Isa Haxhi
Boris Haxhi
Organizues

establi i Bankës së Shqipërisë
Y. Bero

Nr. 255 Prot
24.06.2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BANKA E SHQIPËRISË
GUVERNATORI

Nr. 254 prot.

Tiranë, më 15.06.2022

Lënda: Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë 2022

KOLEGJIT UNIVERSITAR TË BIZNESIT
Prof. Leandro HAXHI
Rektor

I nderuar zoti Rektor,

Nëpërmjet kësaj letre, dëshiroj t'iu informoj për një nga iniciativat e përvitshme të Bankës së Shqipërisë dedikuar studentëve, konkursi “Çmimi i Guvernatorit për Diplomën më të Mirë 2022”.

Kriteret kryesore të pjesëmarrjes në këtë konkurs janë:

- Studentë shqiptarë të diplomuar brenda dhe jashtë vendit;
- Nivel universitar ose pasuniversitar;
- Të kenë përfunduar studimet gjatë periudhës tetor 2021 - shtator 2022;
- Tema e diplomës mbi çështje të lidhura me integrimin dhe zhvillimin ekonomik, ekonomiksën monetar e ndërkombëtar, stabilitetin e çmimeve dhe atë financiar, etj.

Një interes të shtuar për Bankën e Shqipërisë përbën e ardhmja dhe roli i institucioneve kryesore financiare që janë ndikuar nga sfidat që la pas periudha e vështirë e pandemisë dhe përqendrimi i politikave ekonomike tek rigjallërimi i ekonomisë. Tre temat fituese përzgjidhen nga një komision i posaçëm shkencor i ngritur pranë Bankës së Shqipërisë për këtë qëllim, ndërsa shpallja e tyre bëhet në një aktivitet tradicional në ambientet tona.

Banka e Shqipërisë fton të gjithë studentët shqiptarë në Shqipëri dhe mbarë botën të bëhen pjesë e këtij konkursi i cili kurorëzon përpjekjet më të arrira në fushën kërkimore shkencore.

Në këtë kuadër, do ta vlerësonim shumë ndihmën tuaj për të informuar pedagogët dhe studentët duke mundësuar ekspozimin e posterave bashkëlidhur si dhe njoftimin në rrjetet sociale të universitetit tuaj.

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin.

Sinqerisht,

GUVERNATOR

Gent Sejko



